



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2018:056156

Datë: 04.07.2019

Numri i dokumentit: 00393793

P.nr.76/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit I. G. nga fshati S., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm PP/II.nr.191/2018 të datës 23.02.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Mone Sylja, dhe i akuzuari, më datën **02.07.2019**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I. G. nga i ati M., e emë Z., e lindur K., i lindur më ... në fshatin S., komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, me nr.pers. ..., i martuar, i ati i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Nga data e pavërtetuar e deri me dt.16.01.2018 rreth orës 11:20 në fsh. S. Komuna e Rahovecit, konkretisht në shtëpinë e tij, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1.1 të Ligjit mbi armë të Republikës së Kosovës, dhe atë një (1) armë zjarri automatike AK-47 me numër serik 042383-87, një (1) karikator i të njëjtës armë, si dhe katër (4) fishek dhe dy (2) gëzhoja të kalibrit 7.62 mm, të njëjtën armë e ka përdorur duke shtënë dy herë në ajër, derisa është njoftuar policia lidhur me rastin, ku nga zyrtarët policor është sekuestruar arma, karikator, fishekët dhe gëzhojat.

- me këtë ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 73, 74, nenit 374/1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të akuzuarit ia shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit **I. G.**, në shumë prej **një mijë (1,000.00) Euro**, ashtu që dënimin me gjobë është i obliguar ta paguaj në tri (3) këste: këstin e parë në shumë prej **katërqind (400,00) Euro**, duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa këstin e dytë në shumë prej **treqind (300.00) Euro**, dy muaj pas këstit të parë dhe këstin e tretë në shumën prej **treqind (300.00) Euro**, dy muaj pas këstit të dytë.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **pesëdhjetë (50) ditëve**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **njëzet (20) euro, të gjobës**.

I akuzuari obligohet që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I SHQIPTOHET – dënimi plotësues, konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, i konfiskohet arma dhe municioni i përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, si objekt i kryerjes së veprës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, i ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.191/2018 të datës 23.02.2018, kundër të akuzuarit I. G. nga fshati S., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 02.07.2019, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Mone Sylja, dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurori i Shtetit i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtor dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mos pranimit të fajësisë dhe pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet e pranimit të fajësisë. Po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pranimit i

fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme pa kurrfarë presioni dhe aktakuza gjën mbështetjen në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj nga të lartcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par.4 të KPPK-së, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës fillestare është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimi të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë: Raporti i oficerëve T. Z. dhe V. K. të dt. 15.01.2018 dhe 16.01.2018, lista e armës dhe municionit të konfiskuar e dt. 16.01.2018, zingjiri i ruajtjes së armës dt.22.01.2018, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marr sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me gjobë me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor bazohet në nenin 450 paragrafi 2 nënparagrafi 6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Deparamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr76/2018 me datë 02.07.2019

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.